



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:912670

Datë: 18.01.2021

Numri i dokumentit: 01416468

Ac.nr.976/2019

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Gëzim Llulluni kryetar, Nora Bllaca-Dula dhe Halide Reka anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania e Sigurimeve "I..." me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson A.K. nga Prishtina, kundër të paditurit L.R. nga fshati ... Komuna Kaçanik, për rimbursim të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.649/15 të datës 29.10.2018, në seancën e kolegjit e mbajtur më dt.12.01.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e të paditurit L.R. nga fshati ... Komuna Kaçanik, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.649/15 i datës 29.10.2018, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I të dispozitivit, aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditëses Kompania e Sigurimeve "I..." me seli në Prishtinë, si e bazuar. Me të njëjtin aktgjykim në pikën II të dispozitivit, detyrohet i padituri L.R. nga fshati Baicë, Kaçanik, që paditëses Kompania e Sigurimeve "I...", t'ia paguaj shumën prej 616.00€ (gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë euro) në emër të rimbursimit të pagesës së dëmit të shkaktuar, me aksidentin e dt.29.09.2013, të shkaktuar nga i padituri, me kamatën ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e ngritjes së kësaj padie, e deri në pagesën përfundimtare dhe shpenzimet e kësaj procedure në shumë prej 115.00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me forcë

Kundër këtij aktgjykimi, i padituri, brenda afatit ligjor ka paraqitë ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të LPK-së, dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e atakuar të anulon ose të njëjtin të kthej në rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoj shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim me dispozitat e nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se: paditësja me dt.27.10.2015, ka paraqitur padi në gjykatë, me të cilën ka kërkuar nga i padituri ta rimburoj shumën e cekur si në dispozitivin e aktgjykimit (616.00€) në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të dt.29.09.2013, shkaktar i të cilit ishte i padituri, e i cili në ato momente ka qenë duke vozitur nën ndikimin e alkoolit. Nga ky aksident, dëme materiale në veturën e tij, ka pësuar i dëmtuari Arben Osmani nga Ferizaj. Përfaqësuesja e palës paditëse në fund ka mbetur në tërësi si në kërkesëpadi, duke konsideruar se i padituri është shkaktar i aksidentit nga i cili dëme materiale ka pësuar në automjetin e tij i dëmtuari, e në bazë të Ligjit për Auto Përgjegjësinë, paditësja fillimisht ka qenë e obliguar ti kompensoj palët e dëmtuara. Ndërkaq tani, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ka të drejtë që të njëjtën shumë ta rimburoj nga i padituri, ngase duke vozitur nën ndikim të alkoolit, në këtë mënyrë i padituri e ka humbur mbulesën siguruese. Është propozuar aprovimi i kërkesëpadisë dhe pagesa e shpenzimeve procedurale.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të provave ka vërtetuar gjendjen faktike se, nga raporti policor dhe alkotesti, është konstatuar se i padituri ka qenë shkaktar i aksidentit të komunikacionit dhe në ato momente ka qenë duke vozitur nën ndikimin e alkoolit mbi normat e lejuara. Paditësja i ka kompensuar të dëmtuarit, dëmet materiale të pësuar nga ky aksident, në shumë totale si në padi. Sipas Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik me nr. RI.nr.6791/13 i dt.07.03.2017, gjykata ka konstatuar se, ndaj të paditurit është pezulluar procedura kundërvajtëse, lidhur me aksidentin e shkaktuar. Gjykata e shkallës së parë, pretendimet e të paditurit në përgjigjen e tij në padi se, nuk është shpallur fajtor dhe duhet pritur epilogu i procedurës penale, pretendimin e tillë e ka refuzuar, duke u arsyetuar se ndaj të paditurit është pezulluar procedura kundërvajtëse, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale, por, kurrësi nuk është vendosur për pafajësinë e të paditurit dhe vendimi i tillë nuk mund të determinoj epilogun në procedurë kontestimore. Gjykata e ka konsideruar se i padituri është përgjegjës për rimbursimin e dëmit paditëses, në bazë të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia dhe provat e siguruara nga paditësja, të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Këtë gjendjen faktike të çështjes gjykata e shkallës së parë e ka bazuar në dispozitat e nenit 143 të LPK-së, nenit 136, 140, 169, 170, 174 dhe 382 të LMD-së, dhe nenit 14 par.1 pika 3 dhe përshtatshëmrisht, nenit 18.4 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, si dhe nenit 452 par.1 të LPK-së dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë lidhur me këtë çështje juridike, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet ankimore të paditurit, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkeljes esenciale të procedurës, për pa i theksuar shkeljet konkrete dhe dispozitat ligjore të shkelura, por megjithatë, gjykata i analizoj dhe vlerësoj pretendimet e të paditurit, i cili thekson se çështja kontestuese nuk ka qenë kompetencë territoriale e kësaj gjykate, për të shqyrtuar këtë lëndë, duke konsideruar se kjo ka qenë kompetencë e Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, sepse në territorin e saj është shkaktuar dëmi, bazuar edhe në inicimin e procedurës kundërvajtëse në atë gjykatë, si dhe paraprakisht duhet të vërtetohet fajësia, ndërsa nga gjykata-divizioni i kundërvajtjes nuk është shpallur fajtor dhe nuk ka bazë juridike për rimbursim të këtij dëmi.

Gjykata e Apelit, duke i analizuar dhe vlerësuar pretendimet e sipër cekura të paditurit, vlerëson se, duke u nisur nga fakti se i padituri në këtë procedurë nuk ka bërë ndonjë prapësim që gjykata e cila e ka marrë këtë lëndë në shqyrtim, të shpallet jo kompetente, atëherë në kohën kur është marrë aktgjykimi i atakuar dhe lënda është në procedurë ankimore nuk mund të thirret në mos ekzistim të kompetencës territoriale. Situata e tillë është qartë e rregulluar edhe me dispozita ligjore si në vijim:

Me dispozitën e nenit 22 të LPK-së në paragrafin 1 parashihet se” *gjykata mund të shpallet jo kompetente në pikëpamje territoriale vetëm sipas prapësimit të palës së paditur të parashtruar me anë të përgjigjes në padi*”. Ndërkaq në paragrafin 2 të të njëjtit nen thuhet se “ *mbi prapësimin nga paragrafi 1 i këtij neni, gjykata vendos më së voni në seancën përgatitore, përkatësisht në seancën e parë për shqyrtimin kryesor, po që se seanca përgatitore nuk është mbajtur*”. Ndërkaq, paragrafi 3 i nenit në fjalë decidivisht e përcakton se “*gjykata mund të shpallet in kompetente në pikëpamje territoriale, sipas detyrës zyrtare vetëm kur ekziston kompetenca territoriale ekskluzive e ndonjë gjykate tjetër, por më së voni deri në momentin e paraqitjes së përgjigjes në padi*”. Mirëpo në situatën konkrete, asnjëra nga kushtet e më sipërme nuk ekzistojnë që gjykata e cila ka vendosur lidhur me këtë çështje të shpallet in kompetente. Por megjithatë, me vet faktin se procedura ka filluar në gjykatën e shkallës së parë, e njëjta e ka pranuar kompetencën dhe çështja përfundohet në këtë gjykatë.

Gjithashtu, edhe sa i përket pretendimit ankimor se, nuk është vërtetuar fajësia e tij, kjo nuk qëndron, sepse siç rezulton nga Aktvendimi i Gjykatës për Kundërvajtje në Kaçanik, i padituri në atë aktvendim si i pandehur, ndaj tij është pezulluar procedura kundërvajtëse për shkak të parashkrimit absolut për ndjekje, ndërsa gjykata nuk është lëshuar në atë procedurë për vërtetimin e fajësisë së tij, mirëpo, bazuar në shkresat të cilat gjenden në këtë lëndë, paditësi vërtetë ka shkaktuar aksident dhe se i njëjti në ato momente ka qenë nën ndikimin e alkoolit, ku pas matjes me alkotest ka rezultuar se alkooli tek i njëjti është mbi normat e lejuara, pra 1,58 g/kg (promila), fakt i cili është vërtetuar edhe nga analiza dhe konstatimi i aksidentit të komunikacionit, të cilin e ka përpiluar me dt.17.09.2018, eksperti i komunikacionit inxh. H.L.. Në rastin konkret, fajësia dhe përgjegjësia e të paditurit lidhur me këtë aksident ndërlidhet qartë me vozitjen e tij nën ndikimin e alkoolit përtej normave të lejuara dhe kjo është e mjaftueshme që një person të jetë përgjegjës për shkaktimin e ndonjë aksidenti, si në rastin konkret nga ana e të paditurit.

Gjykata e shkallës së parë, me të drejtë e ka refuzuar pretendimin e paditësit, duke u arsyetuar se ndaj të paditurit është pezulluar procedura kundërvajtëse, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale, por, kurrësi nuk është vendosur për pafajësinë e të paditurit dhe vendimi i tillë nuk mund të determinoj epilogun në procedurë kontestimore.

Prandaj Gjykata e Apelit vlerëson se i padituri është përgjegjës për rimbursimin e dëmit paditëses, në bazë të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia dhe provat e siguruara nga paditësja, të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Kështu që, gjykata e shkallës së parë, drejtë dhe plotësisht e ka vërtetuar gjendjen faktike lidhur me këtë çështje kontestuese, duke u bazuar në prova konkrete të cilat janë të bashkangjitura kësaj lënde dhe në këtë aspekt pretendimi ankimor i të paditurit, është i pabazuar. Është fakt se, kompania e sigurimit e mbulon dëmin e shkaktuar, mirëpo jo në situatat, kur shkaktuesi i dëmit ka drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit përtej normave të lejuara.

Me vet faktin se i padituri në momentin kritik, kur ka shkaktua aksidentin ka qenë duke drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit mbi normat e lejuara, atëherë edhe sipas dispozitave ligjore të nenit 14 par.1 pika 1.3 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, ai e humb automatikisht mbulesën siguruese dhe mbetet fajtor i shkaktimit të aksidentit.

Gjykata e Apelit vlerësoi se, pretendimet ankimore të paditurit, përgjithësisht ishin të pa bazuara dhe të njëjtat nuk patën ndonjë bazë ligjore për rastin konkret në mënyrë që të ndikojnë në marrjen e ndonjë vendimi tjetër, nga ai të cilin e ka marr gjykata e shkallës së parë, duke e anuluar të njëjtin, siç ka propozuar i padituri në rastin konkret.

Po ashtu, nga Gjykata e Apelit vlerësohet se, gjykata e shkallës së parë, plotësisht i ka vërtetuar faktet të cilat kanë qenë me rëndësi vendimtare për gjykimin e drejtë të kësaj çështje kontestimore dhe për këto fakte në arsyetimin e aktgjykimit, ka paraqit arsye të plota, sepse nga të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të cilat në detaje janë elaboruar në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar.

Prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje, e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, ndërsa pretendimet ankimore të paditurit, lidhur me këtë çështje u refuzuan të pa bazuara dhe pa mbështetje në prova bindëse.

Meqenëse gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë, e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, dhe nuk ekzistojnë shkelje esenciale të theksuara në ankesë, as shkelje esenciale për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, sipas nenit 194 të LPK-së, konform dispozitës së nenit 195 par.1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, NË PRISHTINË
Ac.nr.976/2019, me dt.12.01.2021

Kryetari i kolegjit- Gjykatësi
Gëzim Lulluni